




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



Datë: 14.03.2022

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 226, të datës 14.03.2022, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, bazuar në nenin 58, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (GZ Nr.28/2008), nenin 43, të Statutit të Komunës, Nr.98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozimi me Nr. 226 të datës 14.03.2022 për kategoritë përfituese dhe kriteret e ndarjes së subvencioneve të arsimit në Komunën e Fushë- Kosovës, si në vijim:
 - 1.1. Të jetë qytetar i Komunës së Fushë Kosovës kopje e letërnjoftimit ose dëshmi e tatimit në tri vitet e fundit;
 - 1.2. Te kenë notën mesatare të studimeve 7.0 e më të lartë;
 - 1.3. Përparësi kanë studentët me degë deficitare si teknike, shkenca natyrore matematikore, mjekësi, arkitekturë etj.
 - 1.4. Studentët me studime jashtë vendit;
 - 1.5. Studentë për vizita studimore jashtë vendit;
 - 1.6. Studentë për vazhdimin e studimeve postdiplomike;
 - 1.7. Arsimtarët me projekte për ngritje të cilësisë;
 - 1.8. Ndihmë për fëmijë me aftësi të kufizuara;
 - 1.9. Bartja (transporti i nxënësve) për fushat e arsimit obligativ të cilat nuk ofrohen në komunën tonë;
 - 1.10. Fëmijë/nxënës me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente të veçanta.
2. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit, nga Kryetari i Komunës.

Akti i dorëzohet:

- 1x Kryetarit të Komunës
- 1x Drejtorisë së Arsimit
- 1x Arkivit

